

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

RAPORT I VLERËSIMIT TË INSTITUCIONIT

NGA STUDENTËT

VITI AKADEMIK 2025–2026

Institucioni	: Universiteti Metropolitan Tirana
Njësia përgjegjëse	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)
Periudha kohore	: 18 – 29 maj 2026
Metoda e plotësimit	: Online – Edu4School
Numri i pjesëmarrësve	: 1037 studentë
Përgatiti	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Data e publikimit	: 08 qershor, 2026

Contents

HYRJE.....	4
METODOLOGJIA.....	4
PËRBËRJA E NJSBC PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026.....	6
1. KARAKTERISTIKAT E PJESËMARRËSVE NË ANKETIM.....	7
Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas gjinisë.....	7
Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas programeve të studimit.....	7
2. SHËRBIMET INFORMATIVE DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT....	10
Kënaqësia me procesin e regjistrimit.....	10
Regjistrimi i lëndëve semestrale.....	10
Efikasiteti i shërbimeve dokumentare.....	11
Informacioni në faqen e internetit të institucionit.....	12
Përmbledhje mbi shërbimet informative dhe administrimin e procesit të regjistrimit.....	12
3. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE MJEDISËT FIZIKE.....	14
Higjiena dhe pastërtia e ambienteve.....	14
Hapësira dhe funksionaliteti i klasave dhe laboratorëve.....	14
Infrastruktura teknologjike.....	15
Shërbimet dhe burimet e bibliotekës.....	16
Përmbledhje mbi infrastrukturën teknologjike dhe mjediset fizike.....	16
4. CILËSIA AKADEMIKE DHE MËSIMDHËNIA.....	18
Përputhshmëria e programit me interesat akademike.....	18
Raporti pedagog-student.....	18
Mbështetja akademike nga pedagogët.....	19
Këshillimi akademik.....	20
Komunikimi me administratën dhe pedagogët.....	20
Aktivitetet jashtëkurrikulare.....	21
Mundësitë për praktika profesionale.....	21
Përmbledhje mbi cilësinë akademike dhe mësimdhënien.....	22
5. PËRGATITJA PROFESIONALE DHE AVANTAZHET KONKURRUESE.....	24
Kënaqësia me zgjedhjen e institucionit.....	24
Tejkalimi i pritshmërive fillestare.....	24
Përfitimi nga aftësitë në gjuhë të huaja.....	25
Përballueshmëria e tarifave të studimit.....	26
Përmbledhje mbi përgatitjen profesionale dhe avantazhet konkurruese.....	26
6. JETA SOCIALE DHE MJEDISI STUDENTOR.....	28
Mjediset sociale në jetën studentore.....	28
Aktivitetet sociale dhe kulturore.....	28
Diversiteti dhe përfshirja sociale.....	29
Shërbimet mjekësore.....	30

Përmbledhje mbi jetën sociale dhe mjedisin studentor	30
7. PJESËMARRJA STUDENTORE DHE PËRFAQËSIMI.....	32
Përfaqësimi i studentëve në organet kolegjiale	32
Hapja ndaj kërkesave dhe sugjerimeve të studentëve	32
Përmbledhje mbi pjesëmarrjen studentore dhe përfaqësimin	33
8. Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen.....	34
Besimi te diploma dhe e ardhmja profesionale	34
Krenaria për përkatësinë ndaj institucionit	34
Vazhdimësia e studimeve në institucion	35
Gatishmëria për të rekomanduar institucionin	36
Rekomandimi i institucionit për cilësinë dhe zhvillimin profesional	36
Përmbledhje mbi ndjenjën e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen	37
9. ANALIZË KRAHASUESE E FUSHAVE TË VLERËSIMIT.....	39
10. ANALIZA E KOMENTEVE DHE SUGJERIMEVE TË STUDENTËVE.....	40
11. GJETJET KRYESORE.....	41
Gjetjet kryesore pozitive	41
Gjetje që kërkojnë vëmendje	42
12. PËRFUNDIME.....	43
ANEKS: PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA STUDENTËT.....	45

HYRJE

Perceptimet e studentëve përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme të informacionit për vlerësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë. Përvoja e tyre e drejtpërdrejtë me procesin mësimor, shërbimet administrative, infrastrukturën, jetën studentore dhe mundësitë e zhvillimit profesional ofron një pasqyrë të vlefshme mbi mënyrën se si funksionon institucioni në praktikë dhe mbi ndikimin që ai ka në formimin akademik dhe personal të studentëve.

Në këtë kuadër, Universiteti Metropolitan Tirana (UMT) zhvillon në mënyrë periodike vlerësimin institucional nga studentët, me qëllim identifikimin e perceptimeve, pritshmërive dhe përvojave të tyre gjatë studimeve. Ky proces përbën një mekanizëm të rëndësishëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke krijuar mundësi për reflektim institucional, monitorim të vazhdueshëm dhe mbështetje të vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Raporti paraqet rezultatet e anketimit të studentëve për vitin akademik 2025–2026 dhe përfshin vlerësimin e shtatë fushave kryesore të përvojës studentore: shërbimet informative dhe administrimin e procesit të regjistrimit, infrastrukturën teknologjike dhe mjediset fizike, cilësinë akademike dhe mësimdhënien, përgatitjen profesionale dhe avantazhet konkurruese, jetën sociale dhe mjedisin studentor, pjesëmarrjen studentore dhe përfaqësimin, si dhe ndjenjën e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen.

Analiza e rezultateve synon të evidentojë prirjet kryesore të perceptimit studentor, pikat e forta të institucionit dhe fushat ku studentët shprehin pritshmëri për zhvillim të mëtejshëm. Në këtë mënyrë, raporti shërben jo vetëm si një instrument vlerësimi, por edhe si një dokument referues për planifikimin e iniciativave që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës studentore dhe forcimin e cilësisë institucionale.

METODOLOGJIA

Ky vlerësim institucional është realizuar në kuadër të proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin Metropolitan Tirana (UMT) dhe bazohet në një nga instrumentet standarde të vlerësimit të përgatitura dhe administruara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Qëllimi i këtij procesi është mbledhja sistematike e perceptimeve të studentëve mbi përvojën e tyre universitare, me synim monitorimin e cilësisë së shërbimeve, identifikimin e pikave të forta dhe mbështetjen e proceseve të përmirësimit të vazhdueshëm institucional.

Pyetësi është strukturuar në shtatë fusha kryesore vlerësimi:

- Shërbimet informative dhe administrimi i procesit të regjistrimit;
- Infrastruktura teknologjike dhe mjediset fizike;
- Cilësia akademike dhe mësimdhënia;
- Përgatitja profesionale dhe avantazhet konkurruese;
- Jeta sociale dhe mjedisi studentor;
- Pjesëmarrja studentore dhe përfaqësimi;
- Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen.

Procesi i mbledhjes së të dhënave u zhvillua nga 19 deri më 29 maj 2026 përmes platformës elektronike *Edu4School*. Plotësimi i pyetësit u realizua në mënyrë anonime, duke garantuar konfidencialitetin e plotë të përgjigjeve dhe duke krijuar kushte që studentët të shprehnin lirshëm perceptimet dhe vlerësimet e tyre.

Në anketim morën pjesë gjithsej 1037 studentë, të përfaqësuar nga të gjitha programet e studimit të ofruara nga UMT në nivelet profesionale, bachelor, master dhe doktoratë. Përmasat e kampionit dhe përfshirja e studentëve nga të gjitha njësitë akademike sigurojnë një bazë të gjerë dhe të besueshme për analizimin e perceptimeve të komunitetit studentor.

Për secilin pohim është përdorur shkalla Likert me pesë nivele vlerësimi, ku:

- 1 = Nuk jam aspak dakord;
- 2 = Nuk jam dakord;
- 3 = As dakord, as kundër;
- 4 = Jam dakord;
- 5 = Jam plotësisht dakord.

Për qëllime analitike, vlerësimet 4 dhe 5 janë grupuar si vlerësime pozitive, pasi tregojnë nivele të ndryshme dakordësie dhe kënaqësie me pohimin. Vlerësimet 1 dhe 2 janë trajtuar si vlerësime negative, ndërsa vlerësimi 3 është konsideruar si qëndrim neutral.

Përpunimi dhe analiza e të dhënave janë realizuar nga *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)*, duke përdorur statistika përshkruese për interpretimin e rezultateve. Në tabelat e paraqitura në raport përdoren treguesit statistikorë të mëposhtëm:

- **Frequency** – numri i studentëve që kanë zgjedhur një alternativë të caktuar përgjigjeje;
- **Percent** – përqindja që kjo kategori përfaqëson ndaj numrit total të përgjigjeje;
- **Valid Percent** – përqindja e llogaritur vetëm mbi përgjigjet e vlefshme;
- **Cumulative Percent** – përqindja e akumuluar progresivisht nga një kategori përgjigjeje te tjetra.

Rezultatet janë analizuar në nivel treguesi, fushe vlerësimi dhe në nivel të përgjithshëm institucional, duke mundësuar identifikimin e prirjeve kryesore të perceptimit studentor dhe krijimin e një panorame të plotë mbi përvojën e studentëve në UMT. Në këtë mënyrë, raporti shërben si një instrument i rëndësishëm për monitorimin e cilësisë dhe për mbështetjen e proceseve të vendimmarrjes dhe zhvillimit institucional.

PËRBËRJA E NJSBC PËR VITIN AKADEMIK 2025–2026

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues nga administrata, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor. Kryetari dhe anëtarët e njësisë janë miratuar nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.

Nr	Emri Mbiemri	Funksioni	Përfaqësimi
1	Dr.Marsida Gorea	Kryetare	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
2	Dr.Almarin Frakulli	Anëtar	Fakulteti i Ekonomisë
3	MSc. Virtyt Lesha	Anëtar	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
4	MSc Albina Joga	Anëtare	Administrata
5	Prof.Asoc.Dr. Ramadan Çipuri	Anëtar	Ekspert i jashtëm
6	Anja Balliu	Anëtare	Përfaqësuese e studentëve

1. KARAKTERISTIKAT E PJESËMARRËSVE NË ANKETIM

Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas gjinisë

Në anketimin institucional morën pjesë gjithsej 1037 studentë. Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 61.1% e pjesëmarrësve janë meshkuj (634 studentë), ndërsa 38.9% janë femra (403 studente). Kjo shpërndarje pasqyron në një masë të konsiderueshme strukturën e programeve të studimit të ofruara nga UMT, ku një pjesë e madhe e studentëve janë të regjistruar në programe të fushave inxhinierike, teknologjike dhe të inteligjencës artificiale, të cilat tradicionalisht karakterizohen nga një përfaqësim më i lartë i studentëve meshkuj. Pjesëmarrja e të dy gjinive siguron një bazë të gjerë perceptimesh dhe kontribuon në rritjen e besueshmërisë së rezultateve të raportit.

Tabela 1 Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas gjinisë

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	403	38.9	38.9	38.9
	Mashkull	634	61.1	61.1	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas programeve të studimit

Të dhënat tregojnë se në anketim janë përfshirë studentë nga të gjitha ciklet dhe programet e studimit që ofron Universiteti Metropolitar Tirana, duke siguruar një përfaqësim të gjerë të komunitetit studentor. Numrin më të lartë të pjesëmarrësve e kanë studentët e **Bachelorit në Inxhinieri Software (10.8%)**, të ndjekur nga **Bachelori në Inxhinieri Kompjuterike (10.1%)**, **Bachelori në Inxhinieri Ndërtimi (9.1%)**, **Masteri i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi (8.7%)** dhe **Bachelori në Informatikë Ekonomike në gjuhën shqipe (8.6%)**. Një përfaqësim të konsiderueshëm kanë gjithashtu programet e **Inxhinierisë Elektrike (7.2%)** dhe **Programi i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë (6.6%)**.

Struktura e pjesëmarrësve reflekton profilin akademik të institucionit, ku programet e fushave të inxhinierisë, teknologjisë së informacionit dhe inteligjencës artificiale zënë peshën kryesore të komunitetit studentor. Në të njëjtën kohë, në anketim janë përfshirë edhe studentë nga programet e biznesit, financës, marketingut, turizmit, dizajnit, si dhe nga programet e studimeve master dhe doktoratë, duke mundësuar që rezultatet e raportit të pasqyrojnë perceptimet e studentëve nga të

gjitha njësité akademike të universitetit.

Përfshirja e studentëve nga programe të ndryshme studimi dhe nga nivele të ndryshme akademike rrit përfaqësueshmërinë e të dhënave dhe krijon një bazë të qëndrueshme për interpretimin e rezultateve në nivel institucional. Në këtë mënyrë, gjetjet e raportit nuk pasqyrojnë perceptimin e një grupi të caktuar studentësh, por ofrojnë një panoramë të gjerë të përvojës studentore në Universitetin Metropolitan Tirana.

Tabela 2 Shpërndarja e studentëve pjesëmarrës sipas programeve të studimit

Programi i studimit (plotëso):					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Bachelor në "Informatike Ekonomike" (anglisht)	50	4.8	4.8	4.8
	Bachelor në "Informatikë Ekonomike" (shqip)	89	8.6	8.6	13.4
	Bachelor në "Inteligjencë Artificiale";	25	2.4	2.4	15.8
	Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike";	105	10.1	10.1	25.9
	Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi";	94	9.1	9.1	35.0
	Bachelor në "Inxhinieri Software" (anglisht);	112	10.8	10.8	45.8
	Bachelor në Administrim Biznesi me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion";	48	4.6	4.6	50.4
	Bachelor në Financë me dy profile: "Kontabilitet", "FinTech";	27	2.6	2.6	53.0
	Bachelor në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime dixhitale", "Kontroll inxhinierik", "Makinieri elektrike";	75	7.2	7.2	60.3
	Doktoratë në "Inteligjenca Artificiale dhe Sistemet Inteligjente"	4	.4	.4	60.7
	Master i Shkencave "REM"	6	.6	.6	61.2
	Master i Shkencave në "Artificial Intelligence"	34	3.3	3.3	64.5
	Master i Shkencave në "Business Analytics & Artificial Intelligence"	25	2.4	2.4	66.9
	Master i Shkencave në "Ekonomik – MBA";	10	1.0	1.0	67.9
	Master i Shkencave në "Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku"	19	1.8	1.8	69.7

Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike";	23	2.2	2.2	71.9
Master i Shkencave në "Inxhinieri Software";	7	.7	.7	72.6
Master i Shkencave në "Menaxhim në Inxhinieri";	7	.7	.7	73.3
Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile: "Inxhinieri Strukturash", "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti";	90	8.7	8.7	82.0
Master në Inxhinieri Elektrike me dy profile: "Energjetikë", "Automatizim Industrie"	35	3.4	3.4	85.3
Master Profesional në "Marketing Dixhital";	2	.2	.2	85.5
Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë	68	6.6	6.6	92.1
Program Profesional në "Dizajn dhe Zhvillim Software";	26	2.5	2.5	94.6
Program Profesional në "Grafik Dizajn"	24	2.3	2.3	96.9
Program profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Eventë";	32	3.1	3.1	100.0
Total	1037	100.0	100.0	

2. SHËRBIMET INFORMATIVE DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT

Kënaqësia me procesin e regjistrimit

Përvoja e regjistrimit vlerësohet pozitivisht nga shumica e studentëve të anketuar. Konkretisht, 72.1% e tyre kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se procesi perceptohet si i organizuar dhe funksional. Një grup prej 16.3% mban një qëndrim neutral, ndërsa vetëm 11.6% kanë shprehur vlerësime negative (1 dhe 2). Veçanërisht domethënës është fakti se më shumë se gjysma e studentëve (54.2%) janë shprehur plotësisht dakord me këtë pohim.

Tabela 3 Kënaqësia me procesin e regjistrimit në programin e studimit

Jam i kënaqur me përvojën time të regjistrimit në programin e studimit që studioj					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	64	6.2	6.2	6.2
	2	56	5.4	5.4	11.6
	3	169	16.3	16.3	27.9
	4	186	17.9	17.9	45.8
	5	562	54.2	54.2	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Këto rezultate sugjerojnë një nivel të lartë kënaqësie me mënyrën se si institucioni menaxhon procesin e regjistrimit të studentëve.

Regjistrimi i lëndëve semestrale

Përceptimi i studentëve ndaj procesit të regjistrimit të lëndëve semestrale rezulton kryesisht pozitiv. Në total, 76.2% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e studentëve e konsiderojnë këtë proces të qartë dhe pa komplikime të panevojshme. Një qëndrim neutral është shprehur nga 12.3% e studentëve, ndërsa 11.5% kanë dhënë vlerësime negative (1 dhe 2). Gjithashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve (57.4%) janë shprehur plotësisht dakord me këtë pohim, çka përfaqëson nivelin më të lartë të vlerësimit individual.

Tabela 4 Vlerësimi i procesit të regjistrimit të lëndëve semestrale

Regjistrimi i lëndëve semestrale kryhet në mënyrë të qartë dhe pa komplikime					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	62	6.0	6.0	6.0
	2	57	5.5	5.5	11.5
	3	128	12.3	12.3	23.8
	4	195	18.8	18.8	42.6
	5	595	57.4	57.4	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo tablo vlerësimesh reflekton një përvojë përgjithësisht të kënaqshme të studentëve në një nga proceset më të rëndësishme administrative të vitit akademik.

Efikasiteti i shërbimeve dokumentare

Shërbimi për lëshimin e dokumenteve studentore vlerësohet pozitivisht nga një pjesë e konsiderueshme e studentëve. Në total, 72.2% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se procedurat për pajisjen me dokumente si vërtetimet dhe transkriptet perceptohen si të shpejta dhe efikase. Një qëndrim neutral është shprehur nga 15.6% e studentëve, ndërsa 12.2% kanë vlerësuar negativisht këtë aspekt. Veçanërisht i rëndësishëm është fakti se 55.1% e studentëve janë shprehur plotësisht dakord me pohimin, duke e bërë këtë alternativën më të zgjedhur.

Tabela 5 Vlerësimi i shpejtësisë dhe efikasitetit të shërbimit për lëshimin e dokumenteve studentore

Shërbimi për lëshimin e dokumenteve të studentit, si vërtetimet dhe transkriptet, është i shpejtë dhe efikas					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	76	7.3	7.3	7.3
	2	51	4.9	4.9	12.2
	3	162	15.6	15.6	27.9
	4	177	17.1	17.1	44.9
	5	571	55.1	55.1	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Në tërësi, rezultatet pasqyrojnë një nivel të mirë kënaqësie me funksionimin e këtij shërbimi administrativ dhe aftësinë e tij për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve në kohë të arsyeshme.

Informacioni në faqen e internetit të institucionit

Një nga vlerësimet më pozitive në këtë seksion lidhet me informacionin që institucioni ofron përmes faqes së tij zyrtare të internetit. Në total, 75.0% e studentëve kanë shprehur vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se faqja konsiderohet një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm informacioni për çështjet akademike dhe aktivitetet studentore. Ndërkohë, 13.9% e të anketuarve kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 11.1% kanë shprehur vlerësime negative. Veçanërisht domethënës është fakti se 59.0% e studentëve janë shprehur plotësisht dakord me këtë pohim, duke përbërë përqindjen më të lartë të vlerësimit maksimal në këtë seksion.

Tabela 6 Vlerësimi i mjaftueshmërisë së informacionit në faqen e internetit të UMT-së

Faqja e internetit e institucionit ofron informacion të mjaftueshëm mbi orarin mësimor, regjistrimet dhe aktivitetet akademike e sociale					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	53	5.1	5.1	5.1
	2	62	6.0	6.0	11.1
	3	144	13.9	13.9	25.0
	4	166	16.0	16.0	41.0
	5	612	59.0	59.0	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Këto rezultate tregojnë se faqja e internetit luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe orientimin e studentëve gjatë jetës së tyre akademike.

Përmbledhje mbi shërbimet informative dhe administrimin e procesit të regjistrimit

Rezultatet e këtij seksioni tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv të studentëve për shërbimet informative dhe proceset administrative të lidhura me regjistrimin. Në të katër treguesit e analizuar, vlerësimet pozitive (4 dhe 5) variojnë nga 72.1% deri në 76.2%, duke dëshmuar se shumica e studentëve i perceptojnë këto shërbime si funksionale, të organizuara dhe të përshtatshme për nevojat e tyre akademike. Veçanërisht mirë vlerësohen procesi i regjistrimit të lëndëve semestrale dhe informacioni i ofruar përmes faqes së internetit të institucionit, të cilat kanë marrë nivelin më të lartë të dakordësisë pozitive në këtë fushë.

Një tjetër tregues i rëndësishëm është fakti se në të gjitha pohimet, më shumë se gjysma e

studentëve kanë zgjedhur alternativën “plotësisht dakord”, duke reflektuar një nivel të lartë besimi ndaj mënyrës së organizimit dhe ofrimit të këtyre shërbimeve. Në të njëjtën kohë, përqindja e vlerësimeve negative mbetet relativisht e ulët, ndërsa një pjesë e studentëve kanë mbajtur qëndrim neutral, çka sugjeron se ekziston ende hapësirë për rritjen e mëtejshme të përvojës së tyre pozitive.

Në tërësi, rezultatet tregojnë se shërbimet informative dhe administrative përbëjnë një nga aspektet e konsoliduara të funksionimit institucional. Megjithatë, ruajtja e këtij niveli kënaqësie dhe përmirësimi i vazhdueshëm i komunikimit, aksesit në informacion dhe efikasitetit të shërbimeve administrative do të kontribuonin në forcimin e mëtejshëm të përvojës studentore.

3. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE DHE MJEDISËT FIZIKE

Higjiena dhe pastërtia e ambienteve

Vlerësimet e studentëve lidhur me higjienën dhe pastërtinë e ambienteve të përbashkëta paraqiten kryesisht pozitive. Në total, 72.5% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke reflektuar një perceptim të favorshëm për kushtet e ofruara në klasa, korridore dhe ambiente sanitare. Ndërkohë, 14.8% e studentëve kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 12.7% kanë shprehur vlerësime negative. Pësia dominuese e përgjigjeve përqendrohet te alternativa maksimale e vlerësimit, e cila është zgjedhur nga 54.1% e studentëve.

Tabela 7 Vlerësimi i higjienës dhe pastërtisë së ambienteve të përbashkëta të institucionit

Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit (tualet, korridore dhe klasa) është e kënaqshme					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	72	6.9	6.9	6.9
	2	60	5.8	5.8	12.7
	3	153	14.8	14.8	27.5
	4	191	18.4	18.4	45.9
	5	561	54.1	54.1	100.0
Total		1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se standardet e mirëmbajtjes dhe pastërtisë perceptohen si një element i rëndësishëm që mbështet një mjedis studimi të përshtatshëm dhe funksional.

Hapësira dhe funksionaliteti i klasave dhe laboratorëve

Sa i përket klasave dhe mjediseve laboratorike, shumica e studentëve kanë shprehur vlerësime pozitive për kushtet e ofruara. Në total, 70.6% e të anketuarve kanë vlerësuar pozitivisht (4 dhe 5) hapësirat dhe ambientet e dedikuara për zhvillimin e mësimi, duke treguar se ato perceptohen si përgjithësisht të përshtatshme për procesin akademik. Një qëndrim neutral është evidentuar te 15.1% e studentëve, ndërsa 14.3% kanë shprehur vlerësime negative. Alternativa më e zgjedhur mbetet vlerësimi maksimal, i përzgjedhur nga 49.6% e të anketuarve, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë shumë të kënaqur me këtë aspekt të infrastrukturës universitare.

Tabela 8 Vlerësimi i përshtatshmërisë së klasave dhe mjediseve laboratorike për

Klasat dhe mjediset laboratorike ofrojnë hapësirë të mjaftueshme dhe një ambient të përshtatshëm për mësim efektiv					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	74	7.1	7.1	7.1
	2	74	7.1	7.1	14.3
	3	157	15.1	15.1	29.4
	4	218	21.0	21.0	50.4
	5	514	49.6	49.6	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Perceptimi dominues i studentëve është se mjediset e mësimdhënies krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin efektiv të aktiviteteve akademike dhe praktike.

Infrastruktura teknologjike

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i përvojës studentore lidhet me infrastrukturën teknologjike të institucionit. Sipas të dhënave, 68.8% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5) për internetin, pajisjet kompjuterike dhe burimet e tjera teknologjike të vëna në dispozicion. Ndërkohë, 17.4% e të anketuarve kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 13.8% kanë shprehur vlerësime negative. Gjysma e studentëve (50.0%) kanë zgjedhur nivelin maksimal të vlerësimit, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e tyre e konsiderojnë infrastrukturën teknologjike të përshtatshme për nevojat e studimit.

Tabela 9 Vlerësimi i infrastrukturës teknologjike në mbështetje të procesit mësimor

Infrastruktura teknologjike e UMT (internet, tabela interaktive, kompjuterët, etj.) plotëson nevojat e mia si student					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	79	7.6	7.6	7.6
	2	64	6.2	6.2	13.8
	3	180	17.4	17.4	31.1
	4	195	18.8	18.8	50.0
	5	519	50.0	50.0	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo prire reflekton një perceptim përgjithësisht pozitiv për mbështetjen teknologjike që institucioni ofron në funksion të procesit akademik.

Shërbimet dhe burimet e bibliotekës

Biblioteka përbën një nga burimet mbështetëse të rëndësishme për procesin e studimit, ndaj edhe perceptimi i studentëve për shërbimet e saj paraqet interes të veçantë. Të dhënat tregojnë se 68.5% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5) për burimet dhe shërbimet e ofruara, duke reflektuar një nivel të mirë kënaqësie ndaj mbështetjes që biblioteka ofron për nevojat akademike. Nga ana tjetër, 15.8% e të anketuarve kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 15.7% kanë shprehur vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është për zgjedhur nga 51.3% e studentëve, duke treguar se për një pjesë të konsiderueshme të tyre biblioteka përfaqëson një mbështetje të vlefshme gjatë studimeve.

Tabela 10 Vlerësimi i burimeve dhe shërbimeve të bibliotekës në mbështetje të studimeve

Jam i kënaqur me burimet dhe shërbimet që ofron biblioteka për mbështetjen e studimeve të mia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	85	8.2	8.2	8.2
	2	78	7.5	7.5	15.7
	3	164	15.8	15.8	31.5
	4	178	17.2	17.2	48.7
	5	532	51.3	51.3	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo prirje evidenton rolin e rëndësishëm që luajnë burimet dhe shërbimet bibliotekare në përmbushjen e kërkesave akademike të studentëve.

Përmbledhje mbi infrastrukturën teknologjike dhe mjediset fizike

Vlerësimet e studentëve tregojnë se infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit perceptohet përgjithësisht në mënyrë pozitive. Nivelet e vlerësimit pozitiv (4 dhe 5) luhaten nga 68.5% deri në 72.5%, duke dëshmuar se shumica e studentëve janë të kënaqur me kushtet që mbështesin procesin mësimor dhe jetën akademike në institucion. Rezultatit më të lartë e merr higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta (72.5%), e ndjekur nga përshtatshmëria e klasave dhe laboratorëve (70.6%), ndërsa infrastruktura teknologjike (68.8%) dhe shërbimet e bibliotekës (68.5%) paraqiten në nivele të ngjashme vlerësimi.

Një element i përbashkët në të katër treguesit është pesha e lartë e vlerësimeve maksimale, të cilat në çdo rast janë zgjedhur nga rreth gjysma e studentëve ose më shumë. Kjo tregon se një pjesë e

konsiderueshme e tyre i konsiderojnë mjediset fizike, pajisjet teknologjike dhe burimet mbështetëse si faktorë që kontribuojnë pozitivisht në përvojën e tyre universitare. Po ashtu, përqindjet e studentëve që kanë mbajtur qëndrim neutral sugjerojnë se ekziston ende hapësirë për forcimin e mëtejshëm të perceptimit pozitiv në disa aspekte të kësaj fushe.

Mesatarisht, kjo fushë ka marrë një vlerësim pozitiv prej 70.1%, çka e pozicionon atë në një nivel të kënaqshëm vlerësimi nga studentët. *Megjithëse rezultatet janë përgjithësisht pozitive, vlerësimet për infrastrukturën teknologjike dhe shërbimet e bibliotekës sugjerojnë se investimet e vazhdueshme në pasurimin e burimeve teknologjike dhe zgjerimin e shërbimeve mbështetëse për studentët mund të kontribuojnë në rritjen e mëtejshme të kënaqësisë së tyre në të ardhmen.*

4. CILËSIA AKADEMIKE DHE MËSIMDHËNIA

Përputhshmëria e programit me interesat akademike

Përzgjedhja e programit të studimit përbën një nga vendimet më të rëndësishme në rrugëtimin akademik të studentëve, ndaj perceptimi i tyre për këtë aspekt paraqet një tregues të rëndësishëm të kënaqësisë akademike. Sipas të dhënave, 77.3% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e shohin programin që ndjekin si të përshtatur me interesat dhe synimet e tyre akademike. Vetëm 9.0% e të anketuarve kanë shprehur vlerësime negative, ndërsa 13.8% kanë mbajtur një qëndrim neutral. Për më tepër, alternativa e vlerësimit maksimal është zgjedhur nga 58.0% e studentëve, përqindja më e lartë ndër të gjitha kategoritë e përgjigjeve.

Tabela 11 Vlerësimi i përputhshmërisë së programit të studimit me interesat dhe objektivat akademike të studentëve

Programi i studimit që kam zgjedhur përputhet me interesat dhe objektivat e mia akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	51	4.9	4.9	4.9
	2	42	4.1	4.1	9.0
	3	143	13.8	13.8	22.8
	4	200	19.3	19.3	42.0
	5	601	58.0	58.0	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo tablo pasqyron një nivel të lartë identifikimi të studentëve me programin e studimit që kanë zgjedhur dhe me drejtimin akademik që ai ofron.

Raporti pedagog–student

Madhësia e grupeve të studimit dhe mundësia për të pasur kontakt më të drejtpërdrejtë me pedagogët përbëjnë elementë të rëndësishëm të cilësisë së përvojës akademike. Në këtë drejtim, vlerësimet e studentëve janë dukshëm pozitive. 78.7% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e konsiderojnë të përshtatshëm raportin midis numrit të pedagogëve dhe studentëve. Vetëm 8.5% kanë shprehur vlerësime negative, ndërsa 12.8% kanë mbajtur një qëndrim neutral. Një tregues domethënës është fakti se 59.4% e studentëve kanë zgjedhur vlerësimin maksimal, përqindja më e lartë e regjistruar deri tani në këtë seksion.

Tabela 12 Vlerësimi i raportit ndërmjet numrit të pedagogëve dhe numrit të studentëve

Mendoj se ka një raport të përshtatshëm midis numrit të pedagogëve dhe numrit të studentëve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	55	5.3	5.3	5.3
	2	33	3.2	3.2	8.5
	3	133	12.8	12.8	21.3
	4	200	19.3	19.3	40.6
	5	616	59.4	59.4	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se studentët perceptojnë një nivel të mirë aksesueshmërie dhe ndërveprimi me stafin akademik gjatë zhvillimit të studimeve.

Mbështetja akademike nga pedagogët

Marrëdhënia ndërmjet studentëve dhe pedagogëve reflektohet edhe në gatishmërinë për të ofruar mbështetje përtej orëve të planifikuara të mësimi. Në këtë aspekt, vlerësimet e studentëve paraqiten mjaft pozitive. Konkretisht, 76.2% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se pedagogët perceptohen si të aksesueshëm dhe të gatshëm për të ndihmuar kur studentët kanë nevojë për sqarime apo orientim akademik shtesë. Një qëndrim neutral është shprehur nga 13.5% e studentëve, ndërsa vetëm 10.3% kanë vlerësuar negativisht këtë tregues. Pjesa më e madhe e përgjigjeve është përqendruar te niveli maksimal i vlerësimit, i zgjedhur nga 56.2% e studentëve.

Tabela 13 Vlerësimi i gatishmërisë së pedagogëve për të ofruar mbështetje akademike jashtë orarit mësimor

Pedagogët janë të gatshëm të japin mbështetje shtesë jashtë orarit të mësimi kur kam pyetje ose kam nevojë për ndihmë akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	57	5.5	5.5	5.5
	2	50	4.8	4.8	10.3
	3	140	13.5	13.5	23.8
	4	207	20.0	20.0	43.8
	5	583	56.2	56.2	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Ky rezultat dëshmon se mbështetja akademike nga stafi akademik konsiderohet një nga elementet e rëndësishme që kontribuojnë në përvojën pozitive të studentëve gjatë studimeve.

Këshillimi akademik

Këshillimi akademik luan një rol të rëndësishëm në orientimin dhe ndjekjen e progresit të studentëve gjatë studimeve. Për këtë tregues, 73.5% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e konsiderojnë procesin e këshillimit si një mekanizëm mbështetës për zhvillimin e rrugëtimit të tyre akademik. Ndërkohë, 14.2% e të anketuarve kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 12.3% kanë shprehur vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është zgjedhur nga 54.3% e studentëve, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë shumë të kënaqur me mbështetjen e marrë përmes këtij procesi.

Tabela 14 Vlerësimi i mbështetjes së ofruar përmes procesit të këshillimit akademik

Procesi i këshillimit akademik siguron mbështetjen e nevojshme për përparimin tim akademik					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	72	6.9	6.9	6.9
	2	56	5.4	5.4	12.3
	3	147	14.2	14.2	26.5
	4	199	19.2	19.2	45.7
	5	563	54.3	54.3	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se këshillimi akademik perceptohet si një instrument i dobishëm që ndihmon studentët në planifikimin dhe përparimin e studimeve të tyre.

Komunikimi me administratën dhe pedagogët

Studentët shprehin një nivel të lartë kënaqësie lidhur me komunikimin që zhvillojnë me administratën dhe pedagogët. Në total, 74.5% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke e konsideruar këtë komunikim të strukturuar dhe të shpejtë. Një qëndrim neutral është evidentuar te 14.8% e studentëve, ndërsa 10.7% kanë shprehur vlerësime negative. Mbi gjysma e studentëve (53.4%) kanë zgjedhur nivelin maksimal të vlerësimit, duke reflektuar një perceptim të favorshëm për mënyrën se si realizohet komunikimi institucional.

Tabela 15 Vlerësimi i komunikimit me administratën dhe stafin akademik

Komunikimi me administratën dhe pedagogët është i strukturuar dhe i shpejtë				
	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	1	54	5.2	5.2	5.2
	2	57	5.5	5.5	10.7
	3	153	14.8	14.8	25.5
	4	219	21.1	21.1	46.6
	5	554	53.4	53.4	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Shpërndarja e përgjigjeve tregon se studentët ndihen përgjithësisht të informuar dhe të mbështetur në ndërveprimet e tyre me strukturat administrative dhe akademike të institucionit.

Aktivitetet jashtëkurrikulare

Përfshirja në aktivitete jashtëkurrikulare shihet nga studentët si një komponent i rëndësishëm i formimit universitar. Sipas rezultateve të anketës, 72.1% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se aktivitetet e organizuara nga institucioni perceptohen si të dobishme për zhvillimin e tyre profesional. Një qëndrim neutral është shprehur nga 16.4% e të anketuarve, ndërsa 11.5% kanë vlerësuar negativisht këtë aspekt. Mbi gjysma e studentëve (53.2%) kanë zgjedhur nivelin maksimal të vlerësimit, duke reflektuar një perceptim të favorshëm për ndikimin që këto aktivitete kanë në pasurimin e përvojës së tyre universitare.

Tabela 16 Vlerësimi i kontributit të aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin profesional të studentëve

Institucioni organizon aktivitete jashtë kurrikulare që më ndihmojnë në zhvillimin tim profesional					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	76	7.3	7.3	7.3
	2	43	4.1	4.1	11.5
	3	170	16.4	16.4	27.9
	4	196	18.9	18.9	46.8
	5	552	53.2	53.2	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Këto vlerësime tregojnë se aktivitetet jashtëkurrikulare konsiderohen nga studentët si një mundësi e vlefshme për zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen e tyre për sfidat profesionale.

Mundësitë për praktika profesionale

Nga analiza e përgjigjeve vihet re se studentët kanë një perceptim kryesisht pozitiv për mundësitë e praktikave profesionale të ofruara në kuadër të programit të studimit. Në total, 68.7% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke vlerësuar kontributin e praktikave në

krijimin e përvojës konkrete të punës dhe në lidhjen e njohurive teorike me realitetin profesional. Një qëndrim neutral është shprehur nga 16.0% e studentëve, ndërsa 15.2% kanë dhënë vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është përzgjedhur nga 50.7% e studentëve, duke treguar se për një pjesë të konsiderueshme të tyre praktikat përfaqësojnë një komponent të vlefshëm të formimit universitar.

Tabela 17 Vlerësimi i mundësive për praktika profesionale dhe përfitimin e përvojës reale të punës

Programi ofron mundësi të vlefshme për praktika profesionale që më ndihmojnë të fitoj përvojë reale pune					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	100	9.6	9.6	9.6
	2	58	5.6	5.6	15.2
	3	166	16.0	16.0	31.2
	4	187	18.0	18.0	49.3
	5	526	50.7	50.7	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Megjithatë, krahas perceptimit përgjithësisht pozitiv, shpërndarja e përgjigjeve sugjeron se ekziston hapësirë për forcimin e mëtejshëm të mundësive praktike dhe zgjerimin e kontakteve të studentëve me mjediset reale të punës.

Përmbledhje mbi cilësinë akademike dhe mësimdhënien

Rezultatet e kësaj fushe paraqesin një nga vlerësimet më të larta në të gjithë pyetësonin, deri në këtë fazë të analizës, duke reflektuar një perceptim shumë pozitiv të studentëve për cilësinë e procesit akademik dhe mbështetjen që marrin gjatë studimeve. Vlerësimet pozitive (4 dhe 5) variojnë nga 68.7% deri në 78.7%, ndërsa në shumicën e treguesve ato tejkalojnë nivelin 70%, duke dëshmuar një shkallë të lartë kënaqësie ndaj aspekteve kryesore të përvojës akademike.

Treguesit më të vlerësuar lidhen me *raportin ndërmjet numrit të pedagogëve dhe studentëve (78.7%), përputhshmërinë e programit të studimit me interesat akademike të studentëve (77.3%) dhe gatishmërinë e pedagogëve për të ofruar mbështetje shtesë jashtë orarit mësimor (76.2%)*. Këto rezultate sugjerojnë se studentët jo vetëm identifikohen me programet që ndjekin, por edhe ndihen të mbështetur nga stafi akademik gjatë zhvillimit të studimeve të tyre.

Në të njëjtën kohë, komunikimi me administratën dhe pedagogët (74.5%), procesi i këshillimit

akademik (73.5%) dhe aktivitetet jashtëkurrikulare (72.1%) paraqesin nivele të qëndrueshme vlerësimi, duke treguar se institucioni ofron një mjedis mbështetës që shkon përtej procesit formal të mësimdhënies. Këta tregues dëshmojnë rëndësinë që studentët i atribuojnë aksesueshmërisë së stafit, orientimit akademik dhe mundësive për zhvillim profesional.

Vlerësimi më i ulët brenda kësaj fushe lidhet me mundësitë për praktika profesionale (68.7%). Megjithatë shumica e studentëve e vlerësojnë pozitivisht këtë aspekt, rezultati sugjeron se ai mbetet një nga elementët me potencialin më të madh për zhvillim të mëtejshëm. *Forcimi i bashkëpunimeve me organizata dhe kompani partnere, si dhe zgjerimi i mundësive për përfshirje praktike të studentëve në mjedise reale pune, mund të kontribuojë në rritjen e mëtejshme të kënaqësisë në këtë drejtim.*

Mesatarisht, fusha e cilësisë akademike dhe mësimdhënies ka marrë një *vlerësim pozitiv prej 74.4%*, duke u renditur ndër fushat më të vlerësuara nga studentët dhe duke reflektuar një nivel të lartë besimi ndaj përmbajtjes së programeve, mbështetjes akademike dhe marrëdhënies me stafin pedagogjik.

5. PËRGATITJA PROFESIONALE DHE AVANTAZHET KONKURRUESE

Kënaqësia me zgjedhjen e institucionit

Perceptimi i studentëve për zgjedhjen e institucionit ku ndjekin studimet përbën një tregues të rëndësishëm të përvojës së tyre universitare. Sipas rezultateve të anketës, 70.9% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke shprehur kënaqësi për faktin që kanë zgjedhur UMT-në për studimet e tyre. Një qëndrim neutral është evidentuar te 15.9% e të anketuarve, ndërsa 13.2% kanë shprehur vlerësime negative. Alternativa e vlerësimit maksimal është zgjedhur nga 52.0% e studentëve, duke treguar se për më shumë se gjysmën e tyre zgjedhja e institucionit është shoqëruar me një përvojë pozitive.

Tabela 18 Vlerësimi i kënaqësisë së studentëve me zgjedhjen e UMT-së si institucion studimi

Jam i kënaqur që kam zgjedhur UMT si institucionin tim të studimeve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	78	7.5	7.5	7.5
	2	59	5.7	5.7	13.2
	3	165	15.9	15.9	29.1
	4	196	18.9	18.9	48.0
	5	539	52.0	52.0	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo prirje pasqyron një nivel të mirë besimi të studentëve ndaj institucionit dhe ndaj vlerës që ai u ofron në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Tejkalimi i pritshmërive fillestare

Pritshmëritë që studentët krijojnë përpara fillimit të studimeve ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si ata vlerësojnë përvojën e tyre universitare. Në këtë tregues, 66.5% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke shprehur mendimin se kushtet e ofruara nga UMT kanë përmbushur ose tejkaluar pritshmëritë e tyre fillestare. Ndërkohë, 17.1% kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 16.4% kanë shprehur vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është zgjedhur nga 47.6% e studentëve, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë pasur një përvojë më pozitive nga sa kishin parashikuar në momentin e regjistrimit.

Tabela 19 Vlerësimi i përmbushjes së pritshmërive të studentëve ndaj kushteve të ofruara nga UMT

Kushtet e ofruara në UMT kanë tejkaluar pritshmëritë e mia fillestare					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	101	9.7	9.7	9.7
	2	69	6.7	6.7	16.4
	3	177	17.1	17.1	33.5
	4	196	18.9	18.9	52.4
	5	494	47.6	47.6	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Shpërndarja e përgjigjeve tregon se shumica e studentëve e vlerësojnë pozitivisht përvojën e tyre në institucion, megjithëse ky tregues evidenton gjithashtu pritshmëri të ndryshme mes grupeve të studentëve. *Rezultati sugjeron se vazhdimi i investimeve në cilësinë e shërbimeve dhe në përvojën studentore mund të kontribuojë në rritjen e mëtejshme të këtij perceptimi pozitiv.*

Përfitimi nga aftësitë në gjuhë të huaja

Njohja e gjuhëve të huaja përbën një nga kompetencat më të kërkuara në tregun bashkëkohor të punës, ndaj perceptimi i studentëve për këtë aspekt paraqet interes të veçantë. Në këtë tregues, 69.6% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke vlerësuar se aftësitë gjuhësore të fituara gjatë studimeve përfaqësojnë një avantazh për zhvillimin e karrierës së tyre. Ndërkohë, 16.2% kanë mbajtur një qëndrim neutral, ndërsa 14.2% kanë shprehur vlerësime negative. Më shumë se gjysma e studentëve (51.0%) kanë zgjedhur alternativën maksimale të vlerësimit, duke reflektuar bindjen se kompetencat gjuhësore të përfituara në institucion mund të rrisin mundësitë e tyre profesionale.

Tabela 20 Vlerësimi i kontributit të aftësive në gjuhë të huaja në zhvillimin profesional të studentëve

Aftësitë në gjuhë të huaja të fituara në këtë institucion përbëjnë një avantazh profesional për karrierën time					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	91	8.8	8.8	8.8
	2	56	5.4	5.4	14.2
	3	168	16.2	16.2	30.4
	4	193	18.6	18.6	49.0
	5	529	51.0	51.0	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se formimi në gjuhë të huaja perceptohet si një element i rëndësishëm i profilit konkurrues të studentëve në tregun e punës. *Megjithatë, rezultati lë të kuptohet se zgjerimi i mundësive për certifikime ndërkombëtare, aktivitete në gjuhë të huaja dhe bashkëpunime me partnerë ndërkombëtarë mund ta forcojë edhe më tej këtë perceptim pozitiv.*

Përballueshmëria e tarifave të studimit

Çështja e tarifave të studimit është ndër aspektet që zakonisht gjeneron vlerësime më kritike nga studentët, pasi lidhet drejtpërdrejt me mundësitë financiare individuale dhe familjare. Megjithatë, rezultatet e këtij treguesi paraqiten përgjithësisht pozitive. Në total, 65.7% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke vlerësuar se tarifat e programit janë të arsyeshme dhe të përballueshme. Një qëndrim neutral është shprehur nga 17.6% e të anketuarve, ndërsa 16.8% kanë dhënë vlerësime negative. Alternativa e vlerësimit maksimal është zgjedhur nga 47.1% e studentëve, duke treguar se pothuajse gjysma e tyre e konsiderojnë plotësisht të pranueshme koston e studimeve në raport me përfitimet që marrin.

Tabela 21 Vlerësimi i arsyeshmërisë dhe përballueshmërisë së tarifave financiare të programit

Tarifat financiare të programit janë të arsyeshme dhe të përballueshme për mua					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	93	9.0	9.0	9.0
	2	81	7.8	7.8	16.8
	3	182	17.6	17.6	34.3
	4	193	18.6	18.6	52.9
	5	488	47.1	47.1	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të këtij treguesi, niveli i vlerësimit pozitiv mund të konsiderohet një sinjal i favorshëm për perceptimin e studentëve ndaj raportit mes koston së studimeve dhe vlerës së ofruar nga institucioni. *Ruajtja e skemave mbështetëse për studentët dhe komunikimi i vazhdueshëm mbi mundësitë e lehtësimit financiar mund të kontribuojnë në forcimin e mëtejshëm të këtij perceptimi pozitiv.*

Përmbledhje mbi përgatitjen profesionale dhe avantazhet konkurruese

Vlerësimet e studentëve për këtë fushë tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv lidhur me

përfitimet që studimet në institucion sjellin për zhvillimin e tyre profesional dhe pozicionimin në tregun e punës. Nivelet e vlerësimit pozitiv (4 dhe 5) variojnë nga 65.7% deri në 70.9%, duke dëshmuar se shumica e studentëve e konsiderojnë përvojën e tyre universitare si një investim me vlerë për të ardhmen akademike dhe profesionale.

Rezultati më i lartë është regjistruar te *kënaqësia për zgjedhjen e UMT-së* si institucion studimi (70.9%), çka sugjeron se shumica e studentëve ndihen të sigurt për vendimin e tyre dhe për rrugën akademike që kanë ndjekur. Në të njëjtën linjë paraqiten edhe vlerësimet për *aftësitë në gjuhë të huaja* (69.6%), të cilat perceptohen si një element i rëndësishëm i profilin profesional dhe konkurrues të studentëve. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e studentëve vlerësojnë pozitivisht edhe faktin që *kushtet e ofruara nga institucioni kanë përmbushur ose tejkaluar pritshmëritë e tyre fillestare* (66.5%).

Vëmendje të veçantë meriton edhe treguesi që lidhet me përballueshmërinë e tarifave të studimit. Edhe pse ky është zakonisht një nga aspektet më të ndjeshme në vlerësimet studentore, 65.7% e të anketuarve kanë shprehur vlerësime pozitive. Ky rezultat mund të konsiderohet domethënës, pasi perceptimet për kostot e studimit priren të jenë më kritike krahasuar me shumicën e treguesve të tjerë institucionalë.

Mesatarisht, kjo fushë ka marrë një *vlerësim pozitiv prej 68.2%*, duke reflektuar një nivel të mirë kënaqësie të studentëve për vlerën që studimet në UMT i shtojnë zhvillimit të tyre profesional. *Megjithëse rezultatet janë përgjithësisht të favorshme, forcimi i mëtejshëm i elementeve që lidhen me ndërkombëtarizimin, mundësitë e certifikimit profesional dhe mbështetjen financiare për studentët mund të ndikojë në rritjen e perceptimit pozitiv për avantazhet konkurruese që ofron institucioni.*

6. JETA SOCIALE DHE MJEDISI STUDENTOR

Mjediset sociale në jetën studentore

Përvoja universitare nuk kufizohet vetëm te procesi mësimor, por ndikohet edhe nga mundësitë që studentët kanë për të ndërtuar marrëdhënie sociale dhe për t'u përfshirë në jetën e kampusit. Në këtë drejtim, 70.1% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke vlerësuar se mjediset sociale të ofruara nga institucioni kontribuojnë pozitivisht në jetën e tyre studentore. Një qëndrim neutral është evidentuar te 16.2% e studentëve, ndërsa 13.7% kanë shprehur vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është zgjedhur nga 53.3% e të anketuarve, duke treguar se për më shumë se gjysmën e tyre këto mjedise përbëjnë një element të rëndësishëm të përvojës universitare.

Tabela 22 Vlerësimi i kontributit të mjediseve sociale në përvojën studentore

Institucioni ofron mjedise sociale që kontribuojnë pozitivisht në jetën time studentore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	75	7.2	7.2	7.2
	2	67	6.5	6.5	13.7
	3	168	16.2	16.2	29.9
	4	174	16.8	16.8	46.7
	5	553	53.3	53.3	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo tablo sugjeron se studentët e perceptojnë institucionin jo vetëm si një hapësirë akademike, por edhe si një mjedis që mbështet ndërveprimin social dhe zhvillimin e jetës studentore.

Aktivitetet sociale dhe kulturore

Përgjigjet e studentëve evidentojnë një vlerësim të favorshëm për aktivitetet sociale dhe kulturore të organizuara nga institucioni. Në total, 72.8% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se këto aktivitete perceptohen si një faktor që pasuron përvojën studentore dhe krijon mundësi shtesë për përfshirje dhe zhvillim personal. Një qëndrim neutral është shprehur nga 16.4% e studentëve, ndërsa vetëm 10.8% kanë dhënë vlerësime negative. Pesha më e madhe e përgjigjeve është përqendruar te vlerësimi maksimal, i përzgjedhur nga 54.0% e të anketuarve.

Tabela 23 Vlerësimi i kontributit të aktiviteteve sociale dhe kulturore në përvojën studentore

Institucioni zhvillon aktivitete sociale dhe kulturore që e pasurojnë përvojën time studentore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	70	6.8	6.8	6.8
	2	42	4.1	4.1	10.8
	3	170	16.4	16.4	27.2
	4	195	18.8	18.8	46.0
	5	560	54.0	54.0	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo prirje tregon se aktivitetet sociale dhe kulturore vlerësohen si një komponent i rëndësishëm i jetës universitare, duke kontribuar në krijimin e një përvoje studentore më të plotë dhe më të larmishme.

Diversiteti dhe përfshirja sociale

Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe nxitja e ndërveprimit ndërmjet studentëve me prejardhje, interesa dhe profile të ndryshme përbën një dimension të rëndësishëm të jetës universitare. Në këtë tregues, 73.5% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke vlerësuar përpjekjet e institucionit për të promovuar diversitetin dhe përfshirjen sociale gjatë vitit akademik. Një qëndrim neutral është shprehur nga 14.9% e të anketuarve, ndërsa 11.6% kanë dhënë vlerësime negative. Alternativa më e zgjedhur rezulton sërish vlerësimi maksimal, i përzgjedhur nga 54.1% e tyre.

Tabela 24 Vlerësimi i aktiviteteve që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale

Përgjatë vitit akademik, institucioni zhvillon aktivitete që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale midis studentëve					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	65	6.3	6.3	6.3
	2	55	5.3	5.3	11.6
	3	155	14.9	14.9	26.5
	4	201	19.4	19.4	45.9
	5	561	54.1	54.1	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve lë të kuptohet se shumica e studentëve e perceptojnë institucionin si një mjedis që nxit bashkëpunimin, respektin reciprok dhe pjesëmarrjen e barabartë në jetën universitare.

Shërbimet mjekësore

Ndryshe nga treguesit e tjerë të kësaj fushe, shërbimet mjekësore përfaqësojnë një mbështetje specifike që studentët e përdorin në shkallë të ndryshme gjatë jetës universitare. Megjithatë, vlerësimet e marra janë kryesisht pozitive. Në total, 68.2% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke shprehur kënaqësi ndaj shërbimeve mjekësore të ofruara nga institucioni. Një qëndrim neutral është evidentuar te 15.9% e të anketuarve, ndërsa po aq, 15.9%, kanë dhënë vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është përzgjedhur nga 52.4% e studentëve, duke treguar se për një pjesë të konsiderueshme të tyre këto shërbime perceptohen si të dobishme dhe të kënaqshme.

Tabela 25 Vlerësimi i kënaqësisë së studentëve me shërbimet mjekësore

Jam i kënaqur nga shërbimet mjekësore					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	109	10.5	10.5	10.5
	2	56	5.4	5.4	15.9
	3	165	15.9	15.9	31.8
	4	164	15.8	15.8	47.6
	5	543	52.4	52.4	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se mbështetja mjekësore vlerësohet pozitivisht nga shumica e studentëve, ndërsa një pjesë e tyre mund të mos kenë pasur kontakt të drejtpërdrejtë ose të shpeshtë me këtë shërbim gjatë periudhës së studimeve. *Rritja e informimit mbi praninë dhe funksionet e shërbimit mjekësor brenda institucionit mund të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësisë dhe të perceptimit pozitiv të studentëve për këtë mbështetje.*

Përmbledhje mbi jetën sociale dhe mjedisin studentor

Rezultatet e kësaj fushe tregojnë se studentët kanë një perceptim pozitiv për aspektet e jetës universitare që lidhen me ndërveprimin social, aktivitetet jashtë auditorëve dhe mjedisin e përgjithshëm studentor. Vlerësimet pozitive (4 dhe 5) luhaten nga 68.2% deri në 73.5%, duke dëshmuar se shumica e studentëve e konsiderojnë institucionin si një hapësirë që ofron mundësi për zhvillim social dhe përfshirje në komunitetin universitar.

Treguesi më i vlerësuar në këtë fushë lidhet me *aktivitetet që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale* (73.5%), i ndjekur nga *aktivitetet sociale dhe kulturore* (72.8%). Këto rezultate sugjerojnë se studentët e perceptojnë pozitivisht angazhimin e institucionit për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe për organizimin e aktiviteteve që pasurojnë përvojën e tyre universitare. Po ashtu, mjediset sociale të ofruara nga institucioni marrin një vlerësim të favorshëm (70.1%), duke treguar se ato konsiderohen një element mbështetës i jetës studentore.

Vlerësimi më i ulët brenda kësaj fushe i përket *shërbimeve mjekësore* (68.2%). Megjithatë, ky rezultat mbetet pozitiv dhe duhet interpretuar në kontekstin e natyrës së këtij treguesi, pasi jo të gjithë studentët kanë nevojë ose përdorin drejtpërdrejt shërbimin mjekësor gjatë studimeve. Për këtë arsye, perceptimi i tyre mund të ndikohet edhe nga niveli i njohjes së këtij shërbimi dhe jo vetëm nga përvoja konkrete e përdorimit të tij. *Rritja e informimit mbi funksionimin dhe disponueshmërinë e mbështetjes mjekësore mund të ndihmojë në forcimin e mëtejshëm të ndërgjegjësimit dhe vlerësimit të studentëve për këtë shërbim.*

Mesatarisht, fusha e jetës sociale dhe mjedisit studentor ka marrë një *vlerësim pozitiv prej 71.2%*, duke reflektuar një nivel të mirë kënaqësie të studentëve për përvojën e tyre jashtë procesit formal të mësimdhënies dhe për mundësitë që institucioni ofron për integrim, bashkëpunim dhe zhvillim personal.

7. PJESEMARRJA STUDENTORE DHE PËRFAQËSIMI

Përfaqësimi i studentëve në organet kolegjiale

Përfshirja e studentëve në strukturat vendimmarrëse përbën një nga mekanizmat kryesorë për garantimin e zërit të tyre në jetën institucionale. Në këtë tregues, 71.9% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e perceptojnë praninë e studentëve në organet kolegjiale si reale dhe funksionale. Një qëndrim neutral është shprehur nga 15.6% e të anketuarve, ndërsa 12.4% kanë dhënë vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është për zgjedhur nga 53.4% e studentëve, duke përfaqësuar alternativën më të zgjedhur në këtë tregues.

Tabela 26 Vlerësimi i përfaqësimit të studentëve në organet kolegjiale të institucionit

Studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	79	7.6	7.6	7.6
	2	50	4.8	4.8	12.4
	3	162	15.6	15.6	28.1
	4	192	18.5	18.5	46.6
	5	554	53.4	53.4	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Këto rezultate sugjerojnë se mekanizmat e përfaqësimit studentor gëzojnë një nivel të mirë njohjeje dhe besimi nga shumica e studentëve. Në të njëjtën kohë, prania e një grupi studentësh me qëndrim neutral tregon se vazhdon të ekzistojë hapësirë për informim më të gjerë mbi rolin dhe kontributin e përfaqësuesve studentorë në organet drejtuese të institucionit.

Hapja ndaj kërkesave dhe sugjerimeve të studentëve

Përveç përfaqësimit formal në organet kolegjiale, rëndësi të veçantë ka edhe mënyra se si institucioni reagon ndaj kërkesave dhe propozimeve që vijnë nga studentët. Në këtë aspekt, 70.9% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e perceptojnë institucionin si të hapur ndaj dialogut dhe bashkëpunimit me përfaqësuesit studentorë. Një qëndrim neutral është evidentuar te 17.2% e studentëve, ndërsa 12.0% kanë shprehur vlerësime negative. Mbi gjysma e të anketuarve (52.7%) kanë zgjedhur nivelin maksimal të vlerësimit, duke reflektuar një perceptim të favorshëm për gatishmërinë e institucionit për të dëgjuar dhe marrë në konsideratë zërin e studentëve.

Tabela 27 Vlerësimi i gatishmërisë së institucionit për të mbështetur kërkesat dhe sugjerimet e përfaqësuesve studentorë

Institucioni nxit kërkesat e përfaqësuesve të studentëve dhe është i hapur për sugjerimet e tyre					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	82	7.9	7.9	7.9
	2	42	4.1	4.1	12.0
	3	178	17.2	17.2	29.1
	4	189	18.2	18.2	47.3
	5	546	52.7	52.7	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se ekziston një nivel i mirë besimi në mekanizmat e komunikimit ndërmjet studentëve dhe strukturave drejtuese të institucionit. *Në të njëjtën kohë, forcimi i mëtijshëm i komunikimit mbi rastet konkrete ku sugjerimet studentore janë reflektuar në vendimmarrje mund të rrisë edhe më shumë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.*

Përmbledhje mbi pjesëmarrjen studentore dhe përfaqësimin

Rezultatet e kësaj fushe paraqesin një tablo pozitive lidhur me përfshirjen e studentëve në jetën institucionale dhe perceptimin e tyre për mekanizmat e përfaqësimit. Të dy treguesit e analizuar kanë marrë vlerësime pozitive mbi 70%, duke treguar se shumica e studentëve besojnë se zëri i tyre përfaqësohet dhe merret në konsideratë në proceset institucionale.

Vlerësimi më i lartë i kësaj fushe i përket *përfaqësimit të studentëve në organet kolegjiale* (71.9%), çka sugjeron se studentët e njohin dhe e vlerësojnë praninë e përfaqësuesve të tyre në strukturat vendimmarrëse të institucionit. Po ashtu, një nivel i ngjashëm vlerësimi evidentohet edhe për *gatishmërinë e institucionit për të dëgjuar dhe mbështetur kërkesat e përfaqësuesve studentorë* (70.9%), duke reflektuar një perceptim pozitiv për dialogun dhe komunikimin ndërmjet studentëve dhe drejtimit të institucionit. Megjithatë rezultatet janë të favorshme, prania e një grupi studentësh me qëndrim neutral në të dy treguesit lë të kuptohet se jo të gjithë studentët janë njësoj të informuar ose të angazhuar me mekanizmat e përfaqësimit. *Për këtë arsye, promovimi i mëtijshëm i rolit të përfaqësuesve studentorë dhe komunikimi më i dukshëm i rezultateve konkrete të angazhimit të tyre mund të kontribuojë në forcimin e mëtijshëm të kulturës së pjesëmarrjes studentore.*

Mesatarisht, fusha e pjesëmarrjes studentore dhe përfaqësimit ka marrë një *vlerësim pozitiv prej 71.4%*, duke treguar një nivel të mirë besimi të studentëve ndaj strukturave përfaqësuese dhe

hapësirave që institucioni ofron për përfshirjen e tyre në jetën akademike dhe institucionale.

8. Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen

Besimi te diploma dhe e ardhmja profesionale

Mënyra se si studentët e vlerësojnë diplomën e institucionit përbën një tregues të rëndësishëm të besimit që ata kanë te formimi i marrë dhe te perspektivat e tyre profesionale. Në këtë tregues, 68.7% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke shprehur se diploma e UMT-së i bën të ndihen krenarë dhe më të sigurt për të ardhmen e tyre profesionale. Një qëndrim neutral është evidentuar te 18.4% e studentëve, ndërsa 12.8% kanë shprehur vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është përzgjedhur nga 50.9% e studentëve, duke treguar se për rreth gjysmën e tyre diploma përfaqëson një burim të rëndësishëm besimi dhe sigurie për karrierën e ardhshme.

Tabela 28 Vlerësimi i ndikimit të diplomës së UMT-së në sigurinë profesionale dhe ndjenjën e krenarisë së studentëve

Diploma e UMT më bën të ndihem krenar dhe të sigurt për të ardhmen time profesionale					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	75	7.2	7.2	7.2
	2	58	5.6	5.6	12.8
	3	191	18.4	18.4	31.2
	4	185	17.8	17.8	49.1
	5	528	50.9	50.9	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Këto rezultate sugjerojnë se shumica e studentëve e lidhin përvojën e tyre universitare me pritshmëri pozitive për zhvillimin profesional, ndërsa një pjesë e qëndrimeve neutrale mund të lidhet me faktin se shumë prej tyre ndodhen ende në procesin e ndërtimit të planeve të tyre të karrierës.

Krenaria për përkatësinë ndaj institucionit

Ndjenja e krenarisë për institucionin ku studiojnë përfaqëson një tregues të rëndësishëm të identifikimit të studentëve me komunitetin universitar. Në këtë drejtim, 70.3% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre ndihen krenarë kur prezantohen si studentë të UMT-së. Një qëndrim neutral është shprehur nga 16.1% e të anketuarve, ndërsa

13.6% kanë dhënë vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është përzgjedhur nga 51.8% e studentëve, duke përbërë alternativën më të zgjedhur në këtë tregues.

Tabela 29 Vlerësimi i ndjenjës së krenarisë për studimet në UMT

Ndihem krenar kur u them të tjerëve se studioj në UMT					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	84	8.1	8.1	8.1
	2	57	5.5	5.5	13.6
	3	167	16.1	16.1	29.7
	4	192	18.5	18.5	48.2
	5	537	51.8	51.8	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Këto rezultate sugjerojnë se studentët kanë krijuar një lidhje pozitive me institucionin dhe se përkatësia ndaj UMT-së perceptohet si pjesë e identitetit të tyre akademik. Prania e një niveli relativisht të lartë të vlerësimeve pozitive tregon gjithashtu se reputacioni dhe imazhi i institucionit gëzojnë një perceptim të favorshëm në mesin e studentëve.

Vazhdimësia e studimeve në institucion

Për studentët, mundësia për të vazhduar formimin akademik brenda të njëjtit institucion përbën një tregues të rëndësishëm të besimit ndaj cilësisë dhe perspektivës së tij afatgjatë. Në këtë tregues, 68.9% e të anketuarve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke shprehur se e shohin UMT-në si universitetin ku mund të zhvillojnë të gjithë ciklin e studimeve të tyre. Një qëndrim neutral është evidentuar te 17.5% e studentëve, ndërsa 13.6% kanë dhënë vlerësime negative. Mbi gjysma e studentëve (51.1%) kanë zgjedhur vlerësimin maksimal, duke reflektuar një nivel të mirë besimi ndaj mundësive që institucioni ofron për vazhdimësinë akademike.

Tabela 30 Vlerësimi i mundësisë për të ndjekur të gjitha nivelet e studimit në UMT

UMT është universiteti ku shoh mundësinë për të përfunduar studimet në të gjitha nivelet akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	91	8.8	8.8	8.8
	2	50	4.8	4.8	13.6
	3	181	17.5	17.5	31.1
	4	185	17.8	17.8	48.9
	5	530	51.1	51.1	100.0

	Total	1037	100.0	100.0	
--	-------	------	-------	-------	--

Rezultatet sugjerojnë se një pjesë e konsiderueshme e studentëve e lidhin të ardhmen e tyre arsimore me institucionin, duke e konsideruar atë si një hapësirë ku mund të ndërtojnë progresivisht formimin e tyre universitar në nivele të ndryshme studimi.

Gatishmëria për të rekomanduar institucionin

Një nga treguesit më domethënës të kënaqësisë institucionale është gatishmëria e studentëve për ta rekomanduar universitetin te të tjerët. Në këtë tregues, 70.1% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e konsiderojnë UMT-në një alternativë të mirë për ndjekjen e studimeve universitare. Një qëndrim neutral është shprehur nga 16.8% e të anketuarve, ndërsa 13.1% kanë dhënë vlerësime negative. Mbi gjysma e studentëve (52.5%) kanë zgjedhur vlerësimin maksimal, duke reflektuar një nivel të mirë besimi ndaj institucionit dhe ndaj përvojës që ai ofron.

Tabela 31 Vlerësimi i gatishmërisë së studentëve për ta rekomanduar UMT-në si një nga zgjedhjet më të mira për studime

E sugjeroj UMT si një nga zgjedhjet më të mira					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	82	7.9	7.9	7.9
	2	54	5.2	5.2	13.1
	3	174	16.8	16.8	29.9
	4	183	17.6	17.6	47.5
	5	544	52.5	52.5	100.0
Total		1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë të gatshëm ta mbështesin reputacionin e institucionit përmes rekomandimeve personale, një tregues që në vlerësimet e arsimit të lartë konsiderohet ndër matësit më të rëndësishëm të kënaqësisë dhe besnikërisë institucionale.

Rekomandimi i institucionit për cilësinë dhe zhvillimin profesional

Një tregues i rëndësishëm i perceptimit institucional lidhet me gatishmërinë e studentëve për ta rekomanduar universitetin te persona që kërkojnë një arsim cilësor dhe mundësi të mira zhvillimi. Në këtë tregues, 70.8% e studentëve kanë dhënë vlerësime pozitive (4 dhe 5), duke treguar se shumica e tyre e lidhin përvojën në UMT me standarde të kënaqshme të formimit akademik dhe

zhvillimit personal e profesional. Një qëndrim neutral është shprehur nga 16.2% e të anketuarve, ndërsa 13.0% kanë dhënë vlerësime negative. Vlerësimi maksimal është për zgjedhur nga 52.2% e studentëve, duke reflektuar një nivel të mirë besimi ndaj cilësisë së ofruar nga institucioni.

Tabela 32 Vlerësimi i gatishmërisë për të rekomanduar UMT-në për edukim cilësor dhe mundësi zhvillimi

Sugjerorj UMT për ata që kërkojnë një edukim cilësor dhe mundësi të shkëlqyera zhvillimi					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	84	8.1	8.1	8.1
	2	51	4.9	4.9	13.0
	3	168	16.2	16.2	29.2
	4	193	18.6	18.6	47.8
	5	541	52.2	52.2	100.0
	Total	1037	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje e përgjigjeve sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e studentëve jo vetëm që janë të kënaqur me përvojën e tyre universitare, por janë gjithashtu të gatshëm ta mbështesin reputacionin e institucionit përmes rekomandimeve ndaj studentëve të ardhshëm.

Përmbledhje mbi ndjenjën e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen

Kjo fushë përmbledh disa nga treguesit më domethënës të perceptimit institucional, pasi lidhet me mënyrën se si studentët e shohin veten në raport me universitetin, me diplomën që do të marrin dhe me perspektivat e tyre të ardhshme akademike e profesionale. Në të pesë treguesit e analizuar, vlerësimet pozitive (4 dhe 5) variojnë nga 68.7% deri në 70.8%, duke reflektuar një nivel të qëndrueshëm besimi dhe identifikimi me institucionin.

Rezultati më i lartë është regjistruar për *gatishmërinë për të rekomanduar UMT-në si institucion për ata që kërkojnë një edukim cilësor dhe mundësi zhvillimi* (70.8%), i ndjekur nga krenaria për të studiuar në UMT (70.3%) dhe gatishmëria për ta rekomanduar universitetin si një nga zgjedhjet më të mira për studime (70.1%). Këta tregues kanë një rëndësi të veçantë, pasi në vlerësimet bashkëkohore të arsimit të lartë rekomandimi personal konsiderohet një nga treguesit më të fortë të kënaqësisë dhe besimit ndaj institucionit.

Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e studentëve e lidhin diplomën e UMT-së me sigurinë dhe zhvillimin e tyre profesional (68.7%), ndërsa shprehin gatishmëri për të vazhduar studimet në të njëjtin institucion edhe në nivele të tjera akademike (68.9%). Këto rezultate tregojnë se shumica e studentëve nuk e shohin përvojën universitare si një proces të kufizuar vetëm në ciklin aktual të

studimit, por si pjesë të një marrëdhënieje më afatgjatë me institucionin.

Mesatarisht, kjo fushë ka marrë një *vlerësim pozitiv prej 69.8%*, duke dëshmuar një nivel të mirë të ndjenjës së përkatësisë, besimit institucional dhe pritshmërive pozitive për të ardhmen. Duke qenë se këta tregues pasqyrojnë në mënyrë të tërthortë efektin e përvojës studentore në tërësi, rezultatet mund të konsiderohen një tregues i rëndësishëm i perceptimit pozitiv që studentët kanë për institucionin dhe për vlerën që ai i shton zhvillimit të tyre akademik e profesional.

9. ANALIZË KRAHASUESE E FUSHAVE TË VLERËSIMIT

Nr.	Fusha e vlerësimit	Vlerësimi pozitiv mesatar
1	Cilësia akademike dhe mësimdhënia	74.4%
2	Shërbimet informative dhe administrimi i procesit të regjistrimit	73.9%
3	Pjesëmarrja studentore dhe përfaqësimi	71.4%
4	Jeta sociale dhe mjedisi studentor	71.2%
5	Infrastruktura teknologjike dhe mjediset fizike	70.1%
6	Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen	69.8%
7	Përgatitja profesionale dhe avantazhet konkurruese	68.2%

Tabela krahasuese tregon se të gjitha fushat e vlerësimit kanë marrë një nivel pozitiv mbi 68%, çka dëshmon një perceptim përgjithësisht të favorshëm të studentëve për përvojën e tyre në UMT. Fusha më e vlerësuar është **cilësia akademike dhe mësimdhënia** me 74.4%, e cila lidhet drejtpërdrejt me përmbajtjen e programeve, raportin pedagog–student, mbështetjen akademike dhe komunikimin me stafin. Pas saj renditen **shërbimet informative dhe administrimi i procesit të regjistrimit** me 73.9%, duke treguar se proceset administrative dhe informative perceptohen si funksionale dhe të qarta.

Në grupin e mesëm të vlerësimeve qëndrojnë **pjesëmarrja studentore dhe përfaqësimi** me 71.4%, **jeta sociale dhe mjedisi studentor** me 71.2% dhe **infrastruktura teknologjike dhe mjediset fizike** me 70.1%. Këto fusha tregojnë një nivel të mirë kënaqësie, por *njëkohësisht sugjerojnë se ka ende hapësirë për konsolidim të mëtijshëm, sidomos në drejtim të informimit mbi mekanizmat e përfaqësimit, pasurimit të jetës studentore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve fizike, teknologjike dhe bibliotekare.*

Fushat me vlerësim relativisht më të ulët janë **ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen** me 69.8% dhe **përgatitja profesionale dhe avantazhet konkurruese** me 68.2%. Megjithatë këto rezultate mbeten pozitive, ato kërkojnë lexim më të kujdesshëm, sepse lidhen me pritshmëri më afatgjata të studentëve: *besimin te diploma, vazhdimësinë e studimeve, mundësitë profesionale, gjuhët e huaja, praktikat dhe tarifat*. Në këtë kuptim, këto fusha nuk paraqesin dobësi të drejtpërdrejta, por tregojnë drejtimet ku institucioni mund të ndërhyjë për ta forcuar më tej lidhjen midis përvojës akademike dhe perspektivës profesionale të studentëve.

10. ANALIZA E KOMENTEVE DHE SUGJERIMEVE TË STUDENTËVE

Përveç përgjigjeve të strukturuar të pyetësorit, studentëve iu dha mundësia të shprehnin mendimet dhe sugjerimet e tyre përmes një pyetjeje të hapur në fund të anketës. Nga 1037 studentë pjesëmarrës, rreth 450 studentë (43.4%) kanë dhënë komente ose sugjerime me përmbajtje konkrete, ndërsa 587 studentë (56.6%) nuk kanë paraqitur komente shtesë ose janë mjaftuar me përgjigje të shkurtra si “nuk kam koment”, “asgjë”, “jo” dhe formulime të ngjashme.

Analiza e komenteve tregon se një pjesë e konsiderueshme e studentëve kanë shprehur vlerësime pozitive për përvojën e tyre në UMT. Në mënyrë të veçantë, janë evidentuar komente që vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies, gatishmërinë e pedagogëve për të ndihmuar studentët, atmosferën e përgjithshme universitare, si dhe organizimin e procesit akademik. Disa studentë kanë theksuar se ndihen të kënaqur me programin që ndjekin dhe me mundësitë që universiteti ofron për zhvillimin e tyre profesional.

Në të njëjtën kohë, një pjesë e komenteve përmbajnë sugjerime për zhvillime të mëtejshme në disa fusha specifike. Sugjerimi më i shpeshtë lidhet me zgjerimin e mundësive për praktika profesionale, internship-e dhe bashkëpunime më të shumta me tregun e punës. Disa studentë kanë shprehur dëshirën për më shumë aktivitete profesionale, vizita studimore, trajnime dhe kontakte me kompani apo institucione të sektorëve ku synojnë të ndërtojnë karrierën e tyre.

Një grup tjetër komentesh lidhet me infrastrukturën dhe mjediset e studimit. Këto sugjerime janë evidentuar kryesisht nga studentë të programeve teknike dhe inxhinierike, të cilët kanë propozuar përmirësime të mëtejshme të laboratorëve, pajisjeve kompjuterike, internetit dhe hapësirave të dedikuara për studim individual ose punë në grup. Megjithatë, këto komente paraqiten kryesisht si kërkesa për zhvillim të mëtejshëm dhe jo si vlerësime negative ndaj kushteve ekzistuese.

Gjithashtu, disa studentë kanë sugjeruar zgjerimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive, duke vlerësuar se këto iniciativa kontribuojnë në pasurimin e përvojës universitare dhe në forcimin e jetës studentore. Janë evidentuar edhe sugjerime për rritjen e frekuencës së aktiviteteve ndërkombëtare, projekteve me partnerë të huaj dhe mundësive për përfshirje në iniciativa akademike jashtë auditorit.

Në një numër më të kufizuar komentesh janë paraqitur sugjerime që lidhen me procedura të

caktuara administrative, shërbimet studentore dhe proceset e komunikimit institucional. Këto komente nuk paraqesin një prirje dominuese, por tregojnë pritshmërinë e studentëve për një përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve mbështetëse.

Në përgjithësi, komentet e studentëve konfirmojnë rezultatet e analizës sasiore të raportit. Vlerësimet pozitive dominojnë në shumicën e fushave të trajtuara, ndërsa sugjerimet e paraqitura lidhen kryesisht me dëshirën për zgjerimin e mundësive ekzistuese dhe për forcimin e mëtejshëm të përvojës studentore, akademike dhe profesionale në Universitetin Metropolitar Tirana.

11. GJETJET KRYESORE

Analiza e përgjigjeve të studentëve evidenton disa prirje të qarta lidhur me perceptimin e tyre për përvojën akademike dhe institucionale në UMT.

Gjetjet kryesore pozitive

1. **Cilësia akademike përfaqëson pikën më të fortë të vlerësimit institucional.** Treguesit që lidhen me procesin mësimor, raportin pedagog–student dhe mbështetjen akademike kanë marrë vlerësimet më të larta në të gjithë anketën, duke reflektuar besimin e studentëve te stafi akademik dhe te cilësia e mësimdhënies.
2. **Programet e studimit perceptohen si të përshtatura me interesat dhe objektivat akademike të studentëve.** Mbi tre të katërtat e studentëve vlerësojnë pozitivisht përputhshmërinë e programit të zgjedhur me pritshmëritë dhe synimet e tyre akademike.
3. **Proceset administrative dhe informative vlerësohen si funksionale dhe të aksesueshme.** Regjistrimi, regjistrimi i lëndëve, lëshimi i dokumenteve dhe informacioni i ofruar nga institucioni paraqiten ndër aspektet më të vlerësuara të përvojës studentore.
4. **Studentët vlerësojnë pozitivisht jetën sociale dhe klimën gjithëpërfshirëse të institucionit.** Aktivitetet sociale, kulturore dhe iniciativat që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale perceptohen si elementë që pasurojnë përvojën universitare.
5. **Ekziston një nivel i mirë identifikimi dhe besimi ndaj institucionit.** Shumica e studentëve shprehen krenarë që studiojnë në UMT dhe janë të gatshëm ta rekomandojnë institucionin për studentët e ardhshëm.

Gjetje që kërkojnë vëmendje

6. **Përvoja praktike mbetet një nga pritshmëritë kryesore të studentëve për zhvillim të mëtejshëm.** Megjithëse praktikat profesionale vlerësohen pozitivisht, rezultatet sugjerojnë se studentët do të mirëprisnin zgjerimin e mëtejshëm të mundësive për lidhje me tregun e punës dhe përvojë konkrete profesionale.
7. **Burimet bibliotekare dhe infrastruktura teknologjike paraqesin potencial për konsolidim të mëtejshëm.** Vlerësimet pozitive në këto fusha tregojnë një bazë të mirë funksionimi, ndërsa një pjesë e studentëve shprehin pritshmëri për zhvillime të mëtejshme në këtë drejtim.
8. **Mekanizmat e përfaqësimit studentor mund të bëhen më të dukshëm për komunitetin studentor.** Përqindja relativisht e lartë e përgjigjeve neutrale sugjeron se jo të gjithë studentët janë të informuar në të njëjtën masë mbi rolin dhe ndikimin e strukturave përfaqësuese.
9. **Pritshmëritë e studentëve ndaj institucionit vazhdojnë të rriten.** Rezultatet që lidhen me tejkalimin e pritshmërive fillestare tregojnë se studentët kanë pritshmëri të larta ndaj përvojës universitare, duke krijuar mundësi për zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve dhe aktiviteteve institucionale.

12. PËRFUNDIME

Ky raport paraqet perceptimet e studentëve mbi përvojën e tyre në Universitetin Metropolitan Tirana, duke ofruar një pasqyrë të gjerë mbi aspektet akademike, administrative, infrastrukturore dhe sociale të jetës universitare. Analiza e rezultateve tregon se studentët shprehin një nivel përgjithësisht pozitiv kënaqësie në të gjitha fushat e vlerësuara, pa evidentuar asnjë fushë me vlerësim dominues negativ.

Rezultatet më të larta janë regjistruar në fushën e cilësisë akademike dhe mësimdhënies, duke dëshmuar se studentët vlerësojnë pozitivisht përputhshmërinë e programeve me interesat e tyre, raportin pedagog–student, mbështetjen akademike dhe komunikimin me stafin. Po ashtu, proceset administrative dhe shërbimet informative perceptohen si të organizuara dhe funksionale, duke kontribuar në një përvojë pozitive gjatë studimeve.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që del nga analiza është vlerësimi pozitiv i jetës studentore dhe i klimës institucionale. Studentët shprehin perceptime të favorshme për aktivitetet sociale dhe kulturore, për promovimin e diversitetit dhe për mundësitë e ndërveprimit brenda komunitetit universitar. Këto rezultate sugjerojnë se përvoja universitare në UMT nuk perceptohet vetëm përmes procesit mësimor, por edhe përmes dimensionit social dhe zhvillimit personal që institucioni ofron.

Vlerësimet e marra në fushën e pjesëmarrjes studentore dhe përfaqësimit tregojnë se shumica e studentëve e konsiderojnë të rëndësishëm dhe funksional rolin e përfaqësuesve të tyre në jetën institucionale. Njëkohësisht, rezultatet sugjerojnë se ekziston potencial për rritjen e mëtejshme të ndërgjegjësimit të studentëve mbi mekanizmat e përfaqësimit dhe mundësitë e përfshirjes në proceset institucionale.

Nga ana tjetër, treguesit që lidhen me përgatitjen profesionale, praktikat, tarifat e studimit, besimin te diploma dhe vazhdimësinë e studimeve paraqesin vlerësime pozitive, por gjithashtu evidentojnë pritshmëri të larta nga studentët për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre dimensioneve. Këto rezultate reflektojnë jo domosdoshmërisht pakënaqësi, por një kërkesë në rritje për mundësi më të gjera zhvillimi profesional dhe akademik në një mjedis gjithnjë e më konkurrues.

Në tërësi, gjetjet e këtij studimi tregojnë se studentët e perceptojnë UMT-në si një institucion që ofron një përvojë universitare cilësore, me standarde të mira akademike, një mjedis mbështetës

dhe mundësi të rëndësishme zhvillimi. Dominimi i vlerësimeve pozitive në të gjitha fushat e analizuara, së bashku me gatishmërinë e studentëve për ta rekomanduar institucionin dhe për të vazhduar studimet në të, përbëjnë tregues të rëndësishëm të besimit që ata kanë ndaj institucionit dhe rolit të tij në formimin e tyre akademik e profesional.

ANEKS: PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA STUDENTËT

I dashur student,

Ky pyetësor synon t'ju ofrojë një hapësirë për të shprehur mendimet dhe përvojën tuaj mbi studimet dhe mbështetjen që merrni në Universitetin Metropolitar Tirana (UMT), duke na ndihmuar të identifikojmë fushat ku mund të përmirësojmë më tej cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët tanë.

Rezultatet e këtij pyetësori do të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi akademik që reflekton pritshmëritë dhe nevojat e studentëve, duke nxitur një përvojë studimi të plotë dhe të kënaqshme. Përgjigjet tuaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e një vizioni të qartë për përmirësimin e përvojës suaj në UMT.

Ju falënderojmë për kohën, singëritetin dhe angazhimin tuaj për të kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të institucionit tonë!

Gjinia

- Femër
- Mashkull

Programi i studimit (plotëso):

Vlerësoni pohimet e mëposhtme sipas shkallës nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht nga “Nuk jam aspak dakord” deri në “Jam plotësisht dakord”.

Nr.		Pohimi	Vlerësimi				
Shërbimet informative dhe administrimi i procesit të regjistrimit							
1	Jam i kënaqur me përvojën time të regjistrimit në programin e studimit që studioj	1	2	3	4	5	
2	Regjistrimi i lëndëve semestrale kryhet në mënyrë të qartë dhe pa komplikime	1	2	3	4	5	
3	Shërbimi për lëshimin e dokumenteve të studentit, si vërtetimet dhe transkriptet, është i shpejtë dhe efikas	1	2	3	4	5	
4	Faqja e internetit e institucionit ofron informacion të mjaftueshëm mbi orarin mësimor, regjistrimet dhe aktivitetet akademike e sociale	1	2	3	4	5	
Infrastruktura teknologjike dhe mjediset fizike							
5	Higjiena dhe pastërtia e ambienteve të përbashkëta të institucionit (tualetet, korridore dhe klasa) është e kënaqshme	1	2	3	4	5	
6	Klasat dhe mjediset laboratorike ofrojnë hapësirë të mjaftueshme dhe një ambient të përshtatshëm për mësim efektiv	1	2	3	4	5	
7	Infrastruktura teknologjike e UMT (internet, tabela interaktive, kompjuterët, etj.) plotëson nevojat e mia si student	1	2	3	4	5	
8	Jam i kënaqur me burimet dhe shërbimet që ofron biblioteka për mbështetjen e studimeve të mia						
Cilësia Akademike dhe Mësimdhënia							
9	Programi i studimit që kam zgjedhur përputhet me interesat dhe objektivat e mia akademike	1	2	3	4	5	
10	Mendoj se ka një raport të përshtatshëm midis numrit të pedagogëve dhe numrit të studentëve	1	2	3	4	5	
11	Pedagogët janë të gatshëm të japin mbështetje shitesë jashtë orarit të mësimit kur kam pyetje ose kam nevojë për ndihmë akademike	1	2	3	4	5	

12	Procesi i këshillimit akademik siguron mbështetjen e nevojshme për përparimin tim akademik	1	2	3	4	5
13	Komunikimi me administratën dhe pedagogët është i strukturuar dhe i shpejtë	1	2	3	4	5
14	Institucioni organizon aktivitete jashtë kurrikulare që më ndihmojnë në zhvillimin tim profesional	1	2	3	4	5
15	Programi ofron mundësi të vlefshme për praktika profesionale që më ndihmojnë të fitoj përvojë reale pune	1	2	3	4	5
<i>Përgatitja profesionale dhe avantazhet konkurruese</i>						
16	Jam i kënaqur që kam zgjedhur UMT si institucionin tim të studimeve	1	2	3	4	5
17	Kushtet e ofruara në UMT kanë tejkaluar pritshmëritë e mia fillestare	1	2	3	4	5
18	Aftësitë në gjuhë të huaja të fituara në këtë institucion përbëjnë një avantazh profesional për karrierën time	1	2	3	4	5
19	Tarifat financiare të programit janë të arsyeshme dhe të përballueshme për mua	1	2	3	4	5
<i>Jeta sociale dhe mjedisi studentor</i>						
20	Institucioni ofron mjedise sociale që kontribuojnë pozitivisht në jetën time studentore	1	2	3	4	5
21	Institucioni zhvillon aktivitete sociale dhe kulturore që e pasurojnë përvojën time studentore	1	2	3	4	5
22	Përgjatë vitit akademik, institucioni zhvillon aktivitete që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen sociale midis studentëve	1	2	3	4	5
23	Jam i kënaqur nga shërbimet mjekësore	1	2	3	4	5
<i>Pjesëmarrja studentore dhe përfaqësimi</i>						
24	Studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale të institucionit	1	2	3	4	5
25	Institucioni nxit kërkesat e përfaqësuesve të studentëve dhe është i hapur për sugjerimet e tyre	1	2	3	4	5
<i>Ndjenja e përkatësisë dhe implikimet për të ardhmen</i>						
26	Diploma e UMT më bën të ndihem krenar dhe të sigurt për të ardhmen time profesionale	1	2	3	4	5
27	Ndihem krenar kur u them të tjerëve se studioj në UMT					
28	UMT është universiteti ku shoh mundësinë për të përfunduar studimet në të gjitha nivelet akademike					
29	E sugjeroj UMT si një nga zgjedhjet më të mira					
30	Sugjeroj UMT për ata që kërkojnë një edukim cilësor dhe mundësi të shkëlqyera zhvillimi					

1. Bëni komente/sugjerimet tuaja se çfarë mund të bëjmë ndryshe për një administrim më të mirë të institucionit
